

## DREJTORIA E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Nr. 10943 Prot.

"Sekret"

Afati i ruajtjes së klasifikimit 10 vjet

Kopje, Nr. 1

Tiranë, më 01.12.2020

**Lënda:** Dërgohet raporti mbi Kontrollin e Figurës për subjektin e rivlerësimit Z. Arian Zef Ndoja

**Drejtuar:** KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

TIRANË

Në zbatim të kërkesave të nenit 39, pika 2, të Ligjit nr. 84/2016 për "Rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe me kërkesën Tuaj nr. 6473 Prot, datë 29.09.2020, me qëllim integrimin e informacioneve të ardhura pas afatit ligjor<sup>1</sup> të përfundimit të procedurave të kryera nga Grupi i Punës për Kontrollin e Figurës në lidhje me subjektin e rivlerësimit Z. Arian Zef Ndoja, me detyrë prokuror, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Durrës, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) Ju informon se:

1. Me Shkresën Nr. 12317 Prot, datë 02.11.2017, është përcjellë në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit raporti për Kontrollin e Figurës për subjektin e rivlerësimit Z. Arian Zef Ndoja, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

Në vijim të informacioneve të ardhura nga institucioni i verifikimit, në kohështrirje gjatë periudhës së rivlerësimit për përfshirje në korrupsion pasiv të subjektit të rivlerësimit Arian Zef Ndoja, në disa raste, rezultojnë se:

- Gjatë periudhës në të cilën Z. Ndoja ushtronte detyrën si prokuror, në vitet 2018-2019, dyshohet se ka ushtruar ndikim të paligjshëm duke favorizuar persona me precedent penal.
- Për prokurorin Arian Zef Ndoja, disponohen të dhëna [REDAKTUAR] ku, vihemi në dijeni se në vitet 2009-2010 ka patur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. [REDAKTUAR]

Gjithashtu Autoritetet verifikuese na informojnë se :

- Shtetasi [REDAKTUAR] evidentohet si lidhje bashkëpunuese e Arjan Ndojes, i cili sinjalizohet se është përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit aktiv, si dhe ka ndikuar në caktimin e trupës gjyqësore në një proces civil, për një çështje pronësie, për favorizimin e një pale.

<sup>1</sup> Datë 02.11.2017.

- Në ngarkim të shtetasit [REDACTED] administrohen të dhëna të cilat ngrenë dyshime të arsyeshme për përfshirje/pjesë e krimit të organizuar [REDACTED]

- Po kështu shtetasi [REDACTED] sinjalizohet si lidhje e pakonfirmuar e Arjan Ndojës, dhe dyshohet si lidhje e personave të [REDACTED]

Autoritetet verifikuese për personat e lartpërmendur kanë ndarë informacione me Organet Ligj Zbatuese, e konkretisht:

- "[REDACTED] [REDACTED]"

- [REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

Për subjektin e rivlerësimit Arjan Ndoja, referuar burimeve të hapura mediatike të datës 01.11.2019 në lidhje me ngjarjen e ndodhur në zonën e Shkozetit ku subjekti i rivlerësimit mbeti i plagosur nga një atentat me armë zjarri, rezulton se ka qenë i shoqëruar në makinë me shtetasin [REDACTED] lidhje shoqërore e Z. Ndoja. Ky shtetas, rezulton të jetë person me precedent penal dhe me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Aktualisht, kjo ngjarje është në hetim nga ana e Prokurorisë së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në vlerësim të të dhënave që disponohen nga autoritetet verifikuese për subjektin Arjan Ndoja, arsyetojmë të merren parasysh elementët që evidentojnë përfshirjen e tij në veprimtari korruptive dhe në veprimtari të kundërligjshme, të kontakteve të papërshtatshme




SEKRET

me persona të përfshirë në krimin e organizuar, pasi në frymën e ligjit 84/2016, vlerësohet se integriteti profesional është përcaktues për pastërtinë e figurës së subjekteve të rivlerësimit. Sa sipër:

1. Situata pasqyron korrupsionin në vetë sistemin e drejtësisë, ku në rastin në fjalë përfshihet në veprime korruptive një prokuror. Kjo veprimtari e paligjshme i përmbahet përcaktimit të pikës 8 të nenit 3 të ligjit 84/2016, ku përfshihen veprat penale të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale "krimi i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni".
2. Informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, për implikim në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, në rastin tonë të një prokurori, nëpërmjet premtimit apo kërkimit të drejtëpërdrejtë apo tërthorazi, të çfarëdolloj përfitimi të parregullt, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën e tij funksionale, sipas kërkesave të germave "b" e "c" të nenit 37, të ligjit nr 84/2016, e bën subjektin e rivlerësimit individ që mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale.
3. Bazuar në Nenin 38, të ligjit 84/2016, ligjvënësi i është referuar kontakteve të papërshtatshme, që mund të ketë subjekti i rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Nisur nga qëllimi dhe fryma e ligjit, ku procesi i rivlerësimit përfshin kontrollin tërësor të prokurorëve dhe gjyqtarëve, duke filluar nga vetë subjekti e më pas duke zbuluar ose identifikuar lidhjet e subjektit me krimin e organizuar, mësepari subjekti i rivlerësimit është vetë subjekt i kontrollit të ligjit dhe i përfshirjes ose jo në krimin e organizuar.
4. Në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit të pastërtisë së figurës së një subjekti rivlerësimi, në rastin tonë, në cilësinë e prokurorit të Prokurorisë së PRGJ Durrës, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve, në kundërshtim me ligjin, në mospërbushje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime materiale ose jomateriale të padrejta për atë vetë si funksionar publik, apo për persona të lidhur me të, duke dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit apo të personave të tjerë, vlerësojmë se cenohet pastërtia e figurës së subjektit në fjalë dhe shkalla e besueshmërisë së tij.
5. Mbështetur në informacionet e ardhura nga institucionet verifikuese, merret në konsideratë aktualiteti [REDACTED].

Në përfundim, Grupi i Punës nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Arian Zef Ndoja.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.



SEKRET